



RAPORT STATISTIKOR JANAR-MAJ 2025

H y r j e

Raporti synon të japë një përshkrim analitik të treguesve të primeve të shkruara bruto dhe dëmeve të paguara të Tregut të sigurimeve dhe me pas të shoqërisë Insig sh.a për periudhën janar-maj 2025, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si edhe për tregues specifikë të dhënat krahasohen për periudhën janar-maj të viteve nga 2021-2025.

Burimet kryesore mbi të cilat mbështetet raporti janë; Buletini Statistikor zyrtar i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për periudhën janar-maj 2025 dhe të dhënat statistikore të përpunuara për periudhën në shqyrtim, të shoqërisë Insig Sh.a

Tabela e përmbajtjes

1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar-Maj 2025.....	2
1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës	3
1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës	4
2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Maj 2025	5
2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të aksidenteve	6
2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike	7
2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës	8
2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera	8
3. Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar -Maj 2025.....	9
3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike	9
3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit	10


1. Tregu i sigurimeve gjatë periudhës Janar – Maj 2025

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-maj 2025 ka realizuar 10,075,064 mijë lekë prime të shkruara bruto nga tregu i sigurimit të Jetës, JoJetës dhe veprimtaria e risigurimeve duke shënuar rritje me 7.60% krahasuar me periudhën janar-maj 2024. Nga aktiviteti i Jo Jetës janë realizuar 9,125,675 mijë lekë prime duke shënuar një rritje me 7.20% dhe nga aktiviteti i Jetës janë realizuar 945,241 mijë lekë prime duke shënuar një rritje prej 11.61%, kurse veprimtaria e risigurimeve ka realizuar 4,148 mijë lekë duke shënuar një rritje prej 4.35%. Vlera e dëmeve të paguara nga industria e sigurimeve është 3,304,289 mijë lekë me një rënie prej 5.59% krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2024. Njësoj si treguesit e primeve të shkruara, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara afro 90.68% e tyre paguhet nga aktiviteti i Jo Jetës, 4.83% nga aktiviteti i Jetës dhe 4.50% nga dëmet e paguara të fondit të kompensimit.

1.1 Primet e shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës


Totali i primeve të shkruara bruto nga aktiviteti i Jo Jetës është 9,125,675, mijë lekë duke shënuar rritje me 7.20% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Ndikimin kryesor në rezultatin e rritjes së përgjithshme të tregut krahasuar me janar-maj të vitit 2024, ka dhënë rritja në sigurimin e kredive dhe garancive prej 20.69%, e ndjekur nga rritja te përgjegjësi ndaj palëve të treta me 13.03%, rritja te kasko me 7.80% dhe rritja te klasa marinë, aviacion e transport me 1.92%. Klasa e përgjegjësi rezultojnë me rënie prej 17.18%, klasa e aksidenteve e sëmundjeve rezultojnë me rënie prej 5.38% dhe zjarri dhe dëmtimet e tjera në pronë me 6.48%. Ndikimi i tyre i rëndësishëm, vjen nga përpjesa që ata kanë në totalin e tregut. Në grafikun 1 ilustrohen vlerat në përqindje ndryshimi për secilën klasë sigurimi të periudhës janar-maj 2025/2024.

Grafiku 1: Ndryshimi i primeve të shkruara bruto sipas klasave të sigurimit, janar-maj 2025/2024




Duke ju referuar periudhës janar-maj për vitet 2021-2025 sipas grafikut 2, trendi i primeve rezultojnë me rritje nga viti në vit, dhe në vitin 2025 rezultojnë vlera më të lartë.

Grafiku 2: Ecuria e primeve të shkruara bruto tregu i sigurimeve, janar-maj 2021-2024 (mijë lekë)



Tregu vazhdon të dominohet nga klasa e sigurimeve të detyrueshme motorike duke zotëruar 66.22% të totalit të primeve të shkruara bruto, e ndjekur më pas me rreth 12.30% nga sigurimet e pronës ndërsa pjesa tjetër e ndarë midis klasave të tjera. Referuar grafikut 3, ku paraqitet raporti i sigurimeve vullnetare me ato të detyrueshme për periudhën janar-maj, përpjesa që sigurimet vullnetare zënë ndaj sigurimeve totale është më e madhe në periudhën janar-maj të vitit 2023 me 41.83% prime vullnetare ndaj totalit. Ndërkohë që raporti më i ulët paraqitet në periudhën janar-maj të vitit 2025 me 33.78%. Për periudhën raportuese raporti rezulton 33.78% me 66.22%.


Grafiku 3: Raporti vullnetare/totalit për periudhën janar-maj 2021-2025 (mijë lekë)




Referuar sigurimeve të detyrueshme motorike, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë rezultojnë me rritje TPL me 12.73%, kartoni jeshil me 15.75% dhe kufitarja me 6.94%. Numri i kontratave të lidhura për sigurimet e Jo Jetës gjatë periudhës janar-maj 2025 është 539,629 kontrata, duke shënuar rritje prej 8.13% ose 40,590 kontrata më shumë se viti 2024.

Ndërkohë, norma e rritjes së tregut është rreth 7.20% krahasuar me janar-maj 2024.

Grafiku 4: Norma e rritjes së primit, janar-maj 2025/2024




Grafiku 5: Raporti vullnetare/totalit, janar-maj 2025



1.2 Dëmet e paguara nga aktiviteti i Jo Jetës


Gjatë periudhës janar-maj 2025, nga aktiviteti i sigurimit të Jo Jetës janë paguar 2,996,202 mijë lekë dëme, duke shënuar një rënie me 4.27% ose 133,640 mijë lekë pagesa më pak krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2024. Kjo shoqërohet edhe me rritjen e numrit të rasteve të paguara me 4.06% ose 1,163 raste më shumë.

Grafiku 6: Ecuria e dëmeve të paguara nga tregu (mijë lekë), janar-maj 2021-2025



Sipas ilustrimit dhe në grafikun 6, vlera më e lartë e dëmeve të paguara është për periudhën janar-maj të vitit 2024, ndërsa raporti më i lartë është në vitin 2021 prej 44.19%. Grafikun 7, ndryshimi në vlerën e dëmeve të paguara sipas klasave.


Grafiku 7: Ndryshimi në dëmet e paguara sipas klasave të sigurimeve, janar-maj 2025/2024



2. Prime të shkruara bruto nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Maj 2025


Aktiviteti i shoqërisë INSIG për periudhën janar-maj 2025 për Tregun e Sigurimeve të Jo Jetës, u mbyll me një rezultat primesh të shkruar bruto prej 619,339 mijë lekë, duke shënuar **një rritje prej 10.20%** krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2024. Krahasuar me periudhën janar-maj nga vitet 2021-2025 ecuria e primeve të shoqërisë Insig është me rritje nga viti në vit , duke shënuar vlerën më të ulët në janar-maj të vitit 2021, dhe vlerën më të lartë të primeve të realizuara në janar-maj të vitit 2025, paraqitur grafiksht si më poshtë në grafikun 8.

Grafiku 8: Ecuria e primeve te shkruara bruto Insig, janar-maj 2021-2025 në mijë lekë



Raporti i sigurimeve vullnetare ndaj totalit për periudhën janar-maj të vitit 2025 është 12.06% me 87.94%, duke shënuar një rënie në përqindje prej 2.63% të këtij raporti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, ku raporti i vullnetareve ndaj totalit ishte 14.69%. Ecuria e këtij raporti për periudhën janar-maj nga 2021-2025 paraqitet sipas grafikut 9 .


Grafiku 9: Prime vullnetare ndaj totalit Insig, janar-maj 2021-2025 (mijë lekë)



2.1 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të Aksidenteve e Shëndetit

Gjatë periudhës janar-maj të vitit 2025, nga klasa e sigurimit të Aksidenteve dhe Shëndetit janë realizuar 2,818 mijë lekë prime të shkruara bruto duke shënuar një rënie me 46.29% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Primet e realizuara nga ky grup në raport me totalin zënë 0.46% e tyre. Grafiku 10, ilustron ecurinë e primeve të shkruara bruto për periudhën janar-maj nga vitit 2021–2025. Vlera më e ulët e primeve të grumbulluara shënohet për periudhën janar-maj të vitit 2025, ndërsa më e larta për periudhën janar-maj 2023.

Grafiku 10: Primet e shkruara bruto klasa e aksidenteve e shëndetit Insig, janar-maj 2021-2025 (mijë lekë)




2.2 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimeve Motorike

Në klasën e sigurimeve motorike, përfshihen sigurimet e detyrueshme motorike Tpl, Karton Jeshil, Kufitare dhe sigurimet vullnetare motorike, Kasko. Nga klasa e sigurimeve motorike shoqëria Insig për periudhën janar-maj të vitit 2025 ka grumbulluar 582,740 mijë lekë prime të shkruara bruto, duke shënuar rritje me 11.44% Vetëm nga sigurimet e detyrueshme motorike primet e shkruara bruto janë 544,625 mijë lekë, të cilat përbëjnë rreth 93.46% të gjithë primeve të klasës motorike. Nga sigurimet e detyrueshme motorike Tpl zë pjesën më të madhe dhe krahasuar me 2024 ka një rritje 13.53%, Kartoni Jeshil ka një rritje me 14.98% ndërsa Kufitare ka një rritje me 7.13%. Ndërkohë për periudhën janar -maj 2025, primet e shkruara bruto për sigurimin Kasko janë 38,115 mijë lekë, duke shënuar një rënie me 12.32%


krahasuar me vitin 2024. Primet e kësaj klase zënë 6.54% të totalit të motorikeve. Primet e realizuara nga sigurimet motorike, bëjnë pjesën më të madhe të totalit të primeve të INSIG, duke zënë respektivisht 94.09% të tij. Për periudhën janar-maj të viteve nga 2021–2025 trendi i primeve të sigurimeve të detyrueshme motorike është në rritje, ku vlera më e ulët shënohet për janar-maj të vitit 2021 dhe vlera më e lartë në janar-maj të vitit 2025 ,sipas grafikut 11.

Grafiku 31: Ecuria e primeve - klasa e sigurimeve motorike të detyrueshme Insig, janar-maj 2021 - 2025 (mijë lekë)



Trendi i primeve të realizuara për sigurimet Kasko, është i luhatshëm duke parë ecurinë për periudhën janar-maj nga 2021-2024, ku vlera më e ulët shënohet në vitin 2022 dhe vlera më e lartë në vitin 2024, sipas grafikut 12.


Grafiku 42: Ecuria e primeve Insig – klasa e sigurimeve kasko, janar-maj 2021-2025 (mijë lekë)



2.3 Primet e shkruara bruto për klasën e sigurimit të pronës

Në klasën e sigurimeve të Pronës sipas të dhënave të AMF-së, përfshihen përveç sigurimeve nga Zjarri, Forcat e Natyrës dhe Dëmtime të tjera në Pronë edhe sigurimet e punimeve në ndërtim si CAR apo dhe EAR. Totali i primeve të realizuara nga kjo klasë për periudhën janar-maj të vitit 2025 është 14,913 mijë lekë, duke shënuar rënie me 21.98% krahasuar me janar-maj të vitit 2024. Në raport me totalin e primeve të INSIG për periudhën janar-maj të vitit 2025, kjo klasë zë 2.41% të primeve totale të vetë shoqërisë. Ecuria e primeve bruto të kësaj klase për periudhën janar-maj nga 2021-2025 paraqitet në grafikun 13 , ku vihet re që vlera më e ulët i takon vitit 2025 dhe vlera më e lartë arrihet në vitin 2021.


Grafiku 53: Ecuria e primeve Insig - klasa e sigurimeve të pronës, janar-maj 2021-2025 (mijë lekë)



2.4 Primet e shkruara bruto për klasat e tjera

Në klasat e sigurimeve të tjera përfshihen llojet e sigurimeve të Garancive, Mallrave në Transport, Përgjegjësi, Aviacionit dhe Marinës. Totali i primeve të realizuara nga kjo klasë për periudhën janar-maj të vitit 2025 është 18,868 mijë lekë. Në raport me totalin e primeve të realizuara për periudhën janar-maj të vitit 2025, ky grup realizon 3.05% të totalit. Sigurimi i Përgjegjësi zë peshën më të madhe në këtë grup, i ndjekur nga sigurimet e Garancive e me radhë. Totali i primeve të realizuara nga sigurimi i Përgjegjësi për periudhën janar-maj të vitit 2025 është 13,344 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 65.56% krahasuar me janar-maj 2024 ,ndërsa sigurimi i Garancive është 4,296 mijë lekë, duke shënuar një rënie prej 21.77% krahasuar me janar-maj 2024. Me pas vijjnë klasat e tjera të sigurimeve sipas grafikut 14.

Grafiku 64: Ecuria e primeve Insig për klasat e tjera, janar-maj 2021-2025 (mijë lekë)




Klasa te Tjera,	2021	2022	2023	2024	2025
Sigurimi i garancive	8,171	6,552	4,336	5,492	4,296
Sigurimi mall në transport	7	56	0	74	9
Sigurimi i përgjegjësi	22,458	22,890	26,939	8,060	13,344
Sigurimi i avacionit	0	0	0	0	0
Sigurimi i marinës	670	3,791	2,484	1,125	1,219

3.Dëmet e paguara nga shoqëria Insig për periudhën Janar-Maj 2025

Për periudhën janar-maj 2025, totali i dëmëve të paguara nga shoqëria INSIG është 212,762 mijë lekë pagesa përfshirë edhe shpenzimet për trajtimin e dëmeve,duke shënuar një rritje

me 17.80%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024. INSIG renditet në vend të shtatë në treg duke paguar rreth 7.10% të totalit të dëmeve të tregut. Numri i dëmeve të paguara është në rënie me 0.38% ose 4 raste më pak krahasuar me periudhën janar-maj të vitit 2024.


Grafiku 15: Pjesa e dëmeve të paguara nga llojet e sigurimit Insig, janar-maj 2025



Për INSIG, pjesa më e madhe e vlerës së pagesave për periudhën janar-maj 2025 i takon sigurimeve motorike që zënë 99.00% të totalit të pagesave, e ndjekur nga sigurimet aksidenteve dhe shëndetit me 1.00% të totalit të pagesave. Klasat e tjera nuk kanë raportime për këtë periudhë. Më sipër grafiku 20, paraqitja grafike e peshës specifike të pagesave që zë secila klasë ndaj totalit, për periudhën janar-maj 2025.

Duke ju referuar ecursionit të pagesave në vite vihet re që, për periudhën janar-maj nga viti 2021-2025, kemi një luhatje pagesash. Janar-maj i vitit 2025, shënon vlerën më të lartë të pagesave ndërsa viti 2023 shënon raportin më të lartë të dëmeve të paguara prej 35.10%, Raporti me i ulët shëndohet në vitin 2022 me 25.79%. Për Janar-maj 2025 raporti dëme/prime është 34.35%, sipas grafikut 16.

Grafiku 16: Ecuria e dëmeve të paguara të Insig, janar-maj 2021-2025 (mijë lekë)




3.1 Dëmet e paguara nga sigurimet motorike

Sigurimet motorrike për periudhën janar-maj 2025, kapin vlerën prej 210,636 mijë lekë. Nga karahasimi me periudhën janar-maj të vitit 2024, kemi një rritje prej rreth 18.84%. Brenda grupit 8.90% e pagesave i takon sigurimit motorik vullnetar Kasko dhe pjesa tjetër prej 91.10% i takon pagesave për sigurimet e detyrueshme motorike ku, Tpl zë 83.34% ,Kartoni Jeshil 6.48% dhe Kufitare 0.43%. Referuar karahasimit me periudhën janar-maj të vitit 2024, TPL rezulton me rritje prej 19.93%, Kartoni Jeshil rezulton me rritje prej 7.92%, Kufitare rezulton me rritje prej 88.68% dhe Kasko rezulton me rritje prej 15.32%.

3.2 Dëmet e paguar nga sigurimet e Pronës dhe Aksidenteve e Shëndetit

Nga klasa e sigurimit të Pronës , Garancive dhe nga klasa e Përgjegjësi nuk kemi raportime dëmsh për këtë periudhë. Përsa i përket Aksidenteve dhe Shëndetit për periudhën janar-maj 2025, vlera e dëmeve të paguara është 2,126 mijë lekë, me një rritje 3 herë më të lartë krahasuar me vitin 2024. Raporti i dëmeve të paguara ndaj primeve të realizuara për këtë klasë është 75.44%. Grafikisht më poshtë, ecuria e pagesave për periudhën janar-maj 2024-2025 dhe ndryshim në përqindje sipas klasave të sigurimeve.

Grafiku 17: Pagesat sipas klasave dhe ndryshimi në përqindje Insig, janar-maj 2024-2025 (në mijë lekë)



D.Paguara	TPL	Karton Jeshil	Kufitare	Kasko	Aksid, & Shend,	Prona	Garanci	Pergjegjesi
2024	147,852	12,653	486	16,254	478	2,747	-	0
2025	177,321	13,654	917	18,744	2,126	-	-	0
Ndys%.%	19.93%	7.91%	0.00%	15.32%	344.77%	0.00%	0.00%	0.00%

Burimi: AMF & INSIG

